

***SHOQUERIA “A Elezi Company” Sh.p.k***

Date: 27/09/2019

**VENDIM**

I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE  
**SHOQUERISE “A Elezi Company” Sh.p.k**

Sot ne date 27/09/2019 ne seline e shoquerise **“A Elezi Company” Sh.p.k** me Nr NIPT **L93102801D**, administrator Arjanit Elezi, me adresë Golem Rruga Kavaje-Golem, zk.1791, pasuria nr.71/64, moren ne shqyrtim kete rend dite qe:

1. Shoqeria **“A Elezi Company” Sh.p.k** : Do te beje pezullimin e aktivitetit deri ne nje moment te dyte.

Pasi mori ne shqyrtim pikat e rendit te dites Asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie:

**VENDOSI**

1. Te beje pezullimin e aktivitit, me objekt aktiviteti “Investitore ne fushen e turizmit, hotelerise, agjenci turistike, bareve dhe restoranteve. Aktivitet imobilar te pasurive te paluajtshme. Shoqeria mund te realizoje cdo lloj operacioni financiar apo tregetar qe lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, akt-marreveshje me pale te treta brenda limiteve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi. Gjithashtu, shoqeria gjate aktivitetit te saj ka te drejte te perdore marken e vet tregetare, te beje marketingun e prodhimeve dhe sherbimeve te saj si ne vend ashtu edhe jashte tij.” Deri ne nje moment te dyte.

**“A Elezi Company” SHPK**

**Perfaqesuar nga:**

Z. Arjanit Elezi

Ne Mungese Znj. Enkeleda Bozi  
Me prokure Nr.1517 Rep, Nr.719 Kol

*Enkeleda Bozi*  




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**DHOMA E NOTERISË DURRËS**  
Nr. 1517 Rep. 719 Kol.

### **PROKURË E PERGJITHSHME**

Sot, me datë 25-05-2019 (dymijënëntëmbëdhjetë), ditën e shtunë, para meje Noterit Publik Alban S. Gjoci, i regjistruar në Dhomën e Noterisë Durrës, me seli në lagjen Nr.4 Kavajë, u paraqit personalisht shtetësi:

**ARJANIT ELEZI**, i biri i Zabit-it, i dtl; 23-04-1988, banues në lagjen Nr.2, Cerrik, identifikuar me Pasaporte Nr. BB3694446, Nr. Personal I80423015G, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili me vullnetin e tij të lirë më kërkoi redaktimin e këtij akti duke më deklaruar sa vijon:

Per t'u marre me veprimet per pronat, qofte individuale qofte ne bashkepronesi, qofte te lujteshme apo te palujteshme, me veprime me Banken(çdo lloj Banke dhe e çdo lloj niveli qofte), me veprime me Administratën Shteterore, në nivel lokal apo qendror, si dhe me çeshtje Gjyqësore, dua të lë një përfaqësues.

Në këta kushte,

### **EMËROJ**

dhe **caktoj** si përfaqësuese të përgjithshme, **zpj. ENKELEDA BOZI**, e bija Meti-t, e dtl; 24-07-1982, banuese në lagjen Nr.1, Cerrik, e paisur me Leternjoftim ID № 034107197, të ciles i jap këta tagre:

-Të më perfaqësoje në çdo **Zyre te Administratës Shteterore**, lokale dhe qëndrore, për të kërkuar e terhequr dokumenta që janë në emrin tim personal duke nënshkruar çdo akt në terheqjen e tyre, duke përfshire këtu dhe përfaqësimin në Z.V.R.P.P ; D.R.Sh.T.Rr; Zyre Urbanistike (Per Leje Sheshi e Ndertimi), Zyre e gjëndjes civile, qofshin te Bashkise apo njësive administrative të rrethit te Elbasanit apo të çdo rrethi tjeter; në çdo **Dikaster qëndror dhe Ministri**, me të drejtën e ndjekjes së procedurave deri në përfundim të çdo problemi. Gjithashtu të më përfaqësojë në çdo **Zyre Publike Private** (noteri, avokati, topografi, etj. )për çdo problem që mund të paraqitet në emrin tim, duke nënshkruar në çdo akt të atyre zyrave në emrin tim.

-Të më perfaqësoje në çdo lloj **kontratë apo veprim tjetër juridik-**, sipas rastit që do t'i paraqitet, qoftë me cilësine e **blerësit ose pranuesit të dhurimit** (përfituesit të së drejtës së pronësisë) qoftë me cilësinë e **shitësit ose dhuruesit** (humbësit të së drejtës së pronësisë), qoftë pasuri e palujteshme qoftë pasuri e lujtëshme, veprim juridik në emrin tim, duke nënshkruar çdo akt apo kontratë në emrin tim, duke caktuar dhe çmimin e shitjes apo te blerjes (në qoftë se veprimi do të jetë me shitblerje).

-Të më perfaqësoje në çdo lloj **kontrate: Sipërmarrje, Porosie, Qiraje, Hipotekimi, Huapërdorje, etj** me të drejtën e nënshkrimit të akteve përkatese, përcaktimit të çmimit e ndjekjes së kushteve të kontratës, për pronat që do të rezultojë në emrin tim individual, me të drejtën e zgjidhjes së kontratave nëse çmohet prej tij, lëshimit të çdo akti apo deklarate në funksion të këtyre çështjeve, për pronat e mijë.



-Të më perfaqësoje në **veprime me Banken**, në çdo banke te Shqiperise, te çdo lloj niveli te tyre, duke pasur te drejte te hape apo te mbylle llogari bankare; te kryeje te gjithe llojet e operacioneve mbi ato llogari si shtim depozite, terheqje te pjeseshme apo te pergjithshme, shtyrje apo ndryshim afati, vendosje në Bono Thesari, thyerje afati të tyre, etj dhe te nenshkruaje çdo veprim dhe transaksion bankar në emrin tim, **për çdo numër llogarie apo depozite që do të rezultojë apo do të hapë në emrin tim individual**. Ai ka te drejte te kryeje te njejtat veprime deri në terheqjen totale te shumes e mbyllje llogarie.

-Për ndjekjen e çeshtjeve gjyqesore në emrin tim, ka të drejte t'i ndjeke personalisht, në te gjitha institucionet e **Administrates Shteterore** lokale dhe qëndrore, ku do te jete e nevojshme si dhe **ndjekjet(mbrojtjet) Gjyqësore**, Civile, Administrative apo Penale, në te tre shkallet e Gjykimit deri sa Vendimi te marre forme te prere, dhe nese do t'i linde nevoja per mbrojtje me avokat, **te zgjedhe dhe te caktoje avokat**, me te gjitha tagret e duhura per çdo çeshtje, duke e paisur atë me prokurë në emrin tim personal.

-Në çdo rast perfaqsuesja ime, **zngj. Enkeleda Bozi**, ka tagre të lëshojë kuitancë apo deklaratë likujdimi, te veproje në mungesën time, në emër dhe per llogarine time si dhe veprimet e kryera prej tij, do te quhen te mireqena sikur te jene kryer nga une personalisht.

-**Kjo** prokure eshte pa afat dhe i shtrin efektet deri në revokimin, me shkrim te saj, nga une porositesi".

Prokura ju lexua te perfaqësuarit (porositësit), **Arjanit Elezi**, i cili e gjeti në përputhje me vullnetin e shprehur prej tij dhe së bashku me mua e nënshkruajmë atë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 64 e vijues te K.Civil si dhe të ligjit 7829, datë 01.6.1994, unë Noteri e vërtetoj këtë akt sipas ligjit në fuqi.

#### **P O R O S I T È S I:**

*ARJANIT ELEZI*

**N O T E R**  
Alban S. Gjoci